



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
INSPEKTORATI SHTETËROR I ARSIMIT



INDIKATORËT

E RISHIKUAR PËR
KUALITETIN E
PUNËS SË
SHKOLLAVE

Shkup, 2024

Falënderim

Rishikimi i Treguesve të kualitetit të punës së shkollës u përpilua në kuadër të Projektit për avancimin e arsimit fillor, të zbatuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, i financuar me mbështetjen e Bankës Botërore.

Grupi i punës

Përfaqësues të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit:

Antoniella Stojanoska, Inspektore Shtetërore e Arsimit

Nada Nikollova, Inspektore Shtetërore e Arsimit

Sanja Jakimovska, Inspektore Shtetërore e Arsimit

Senad Sulejmani, Inspektor Shtetëror i Arsimit

Bashkëpunëtorë profesional:

Ana Mickovska Raleva, Udhëheqëse e ekipit në Qendrën Maqedonase për Edukim Qytetar

George Nikollov, bashkëpunëtor i Qendrës Maqedonase për Edukim Qytetar



HYRJE

Vlerësimi i vazhdueshëm i kualitetit të punës së shkollave, me qëllim të përmirësimit të punës së tyre dhe zhvillim të vazhdueshëm është një nga detyrat kyçe të sistemit arsimor. Shkollat efektive karakterizohen nga aftësia e tyre për të vlerësuar dhe përmirësuar në mënyrë adekuate performancat e tyre me kalimin e kohës. Kualiteta e një shkolle përcaktohet nga disa faktorë, duke përfshirë arritjet e nxënësve, klimën dhe kulturën e shkollës, kualitetin e e mësimi dhe nxënies, politikat e menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës, etj.

Ky dokument paraqet indikatorët kryesorë për vlerësimin e kualitetit të punës në shkollat, me përshkrime të praktikave të mira drejt të cilave duhet të synojnë të gjitha shkollat në shtet. Qëllimi i dokumentit është të ofrojë tregues të qartë dhe të qëndrueshëm të kualitetit të shkollave dhe motivimin për vlerësimin e vazhdueshëm të kualitetit në mënyrë që të plotësojë nevojat e nxënësve dhe të sigurojë arsim me kualitet të lartë për të gjithë.



PËRSHKRIM I SFERAVE, INDIKATORËVE, TEMAVE DHE NIVELEVE

Indikatorët të cilët janë pjesë e kësaj kornize janë të organizuar në katër sfera kyçe (përkatëse me kornizën për vetëevaluim dhe evaluimin integral) që kanë të bëjnë me aspektet kryesore të punës së shkollës:

1. Planifikimi, mësimi dhe nxënia
2. Arritjet e nxënësve
3. Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë
4. Menaxhimi, udhëheqja dhe hartimi i politikave

Çdo sferë kryesore përmban numër të caktuar indikatorësh për kualitet. Shembull, sfera 1: Planifikimi, mësimi dhe nxënia i përmban indikatorët për kualitet si vijon:

- 1.1 Planifikimi i mësimdhënësve
- 1.2 Procesi mësimor
- 1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia
- 1.4 Vlerësimi si pjesë e mësimi
- 1.5 Aktivitetet dhe garat jashtëshkollore

Secili indikator ka numër të caktuar të temave që kanë të bëjnë me aktivitet të caktuar që ndiqet në shkollë. Shembull, indikator 1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia i përfshijnë temat si vijon:

- 1.3.1. Mjedi dhe atmosfera për nxënie
- 1.3.2. Identifikimi dhe plotësimi i nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve

Më në fund, për secilën temë janë zhvilluar përshkrues konkretë që përshkruajnë gjendjen e pritur të përmbushjes së temës/indikatorët.

Evalumi mbulon katër nivele të arritjeve (shumë mirë, mirë, pjesërisht kënaqshme dhe nuk kënaq), por dy nivele janë përshkruar në detaje (*shumë mirë dhe pjesërisht kënaq*).

Përshkruesit përfshijnë ilustrime specifike që kanë për qëllim të krijojnë të kuptuarit e përbashkët për balancin mes anëve të forta dhe të dobëta të shkollës. Dy nivelet e mbetura (*mirë dhe jo të kënaqshëm*), megjithëse nuk përshkruhen me përshkruesit, vlerësohen në bazë të përshkruesve të arsyetuar për dy nivelet tjera.

Me **shumë mirë** vlerësohen aspektet e punës së shkollës ku mbizotërojnë anët e forta. Mund të ketë një numër të vogël të anëve të dobëta, mirëpo ato nuk ndikojnë konsiderueshëm në përvojën që e kanë nxënësit në shkollë. Edhe pse shumë mirë është standardi më i lartë, megjithatë këtë standard mund ta arrijë çdo shkollë. Ai bën të ditur se shkolla në këtë aspekt punon shumë mirë dhe nuk duhet të bëjë përshtatje më të rëndësishme.

Megjithatë, pritet që shkolla të vazhdojë të mirëmbajë nivelin e lartë të këtij aspekti dhe të përdorë të gjitha mundësitë dhe praktikatat e mira që i ofrohen për përmirësim të mëtejshëm. Nëse shkolla është vlerësuar si shumë mirë, kjo duhet të paraqesë shembull të një shkolle, mënyrat e punës dhe praktikatat e suksesshme e së cilës duhet të ndahen me shkollat e tjera dhe të përsëriten.

Me **mirë** evakuohen aspektet e punës së shkollës ku ka shumë anë të forta. Ka anë të dobëta, por ato as individualisht dhe as në grup nuk kanë ndikim të konsiderueshëm negativ në përvojën që e kanë nxënësit në shkollë. Evaluimi mirë mund të jepet në disa rrethana.

Për shembull, nxënia dhe mësimi janë adekuate dhe si rezultat i kësaj, përvoja e nxënësve është pozitive, megjithatë mund të arrihet te njohuria se nxënësve nuk u ofrohet sfidë e mjaftueshme. Më shpesh, ky aspekt karakterizohet me anë të forta, por ka një ose më shumë anë të dobëta që ndikojnë në kualitetin e përgjithshëm të përvojës që e kanë nxënësit.

Me **pjesërisht kënaq** evaluohen aspektet e punës së shkollës që kanë disa anë të forta, por gjithashtu kanë edhe anë të konsiderueshme të dobëta që ndikojnë në përvojën e nxënësve. Në tërësi, kur evaluohet me *pjesërisht kënaq*, kjo do të thotë se shkolla duhet të ndërmarë aktivitete strukturore dhe me kohë për të përmirësuar situatat.

Evaluimi *pjesërisht kënaq* mund të jepet në rrethana të shumta. Mund të ketë anë të forta, por, po ashtu, edhe anë të dobëta që individualisht ose në grup mund të dëmtojnë kualitetin e punës së shkollës.

Me **nuk kënaq** evaluohen ato aspekte të punës së shkollës kur ekzistojnë anë të dobëta të rëndësishme që kërkojnë aktivitete plotësuese nga shkolla. Përvoja e nxënësve është rrezikuar në disa aspekte kyçe. Në shumicën e rasteve, mësimi është vlerësuar si e *pakënaqshme* dhe nevojitet mbështetje plotësuese nga drejtoria në

planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të duhura për përmirësim. Kjo mund të përfshijë nevojën për mbështetje nga kolegët me përvojë nga shkolla ose jashtë saj.





KUANTIFIKIMI I PËRSHKRUESVE

Në përshkruesit për secilën temë, shfaqen shprehje që shënojnë kuantitet, respektivisht sasinë e subjekteve të cilave u referohet një gjendje e caktuar (p.sh. numri më i madh i mësimdhënësve, një numër i vogël i nxënësve, etj.).

Me qëllim të paraqitjes uniforme të informacionit, shprehjet për kuantitet duhet të korrespondojnë me të dhënat procentuale që janë marrë në mënyra të ndryshme (anketat, listat e pjesëmarrjes, etj.), në përputhje me udhëzimet si vijon:

100% - 80%	Numri më i madh
79% - 50%	Numër i madh
49% - 30%	Numër i vogël
29% - 0%	Numër i pakonsiderueshëm



TRIANGULIMI I TË DHËNAVE


Për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e indikatorëve për kualitet të shkollave, është me rëndësi thelbësore të përdoren një varg të dhënash nga burimet e ndryshme (i ashtuquajtur triangulim) meqë asnjë masë nuk mund të japë pasqyrë inkluzive.

Kjo përfshin mbledhjen dhe analizimin e të dhënave nga burime të shumta, siç janë të dhënat për arritjet e nxënësve, vëzhgimet e mësimeve dhe informacionet kthyes nga prindërit dhe nxënësit. Me triangulimin e të dhënave, shkollat mund të fitojnë të kuptuarit më inkluziv për performancat e tyre dhe t'i identifikojnë më saktë sferat për përmirësim.

Ekzistojnë disa mënyra në të cilat mund të mbledhen dëshmi për nivelet e kualitetit: përmes bisedave me palët e interesuara, plotësimit dhe analizimit të rezultateve nga pyetësorët anketues, vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe analizës së dokumenteve.

Më poshtë (Figura 1) është dhënë shembull i llojeve të ndryshme të të dhënave që mund/duhet të mbledhen për të dhënë një pasqyrë sa më inkluzive dhe reale për situatat në shkollë.

Foto 1. Triangulimi i të dhënave



Si plotësim të çdo indikator ekziston një pjesë me burimet e të dhënave nga të cilat shkollat dhe inspektorët duhet të marrin informacionet relevante për secilin indikator.

SFERA 1. PLANIFIKIM, MËSIM DHE NXËNIE

NUMRI	INDIKATORI	TEMA
1.1	Planifikimet e mësimdhënësve	- Mbështetja dhe ndjekja e planifikimeve të mësimdhënësve - Shkëmbimi i përvojave dhe informacionet gjatë planifikimit
1.2	Procesi mësimor	- Realizimi i planeve dhe programeve mësimore - Përzgjedhja e lëndëve mësimore - Përzgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve - Ndërveprimi mes mësimdhënësve dhe nxënësve dhe nxënësve mes vete - Realizimi i inkluzionit arsimor - Aktivitete për integrimin ndëretnik në arsim
1.3	Përvoja e nxënësve nga nxënia	- Mjedisi dhe atmosfera për nxënie - Identifikimi dhe plotësimi i nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve
1.4	Notimi si pjesë e mësimi	- Politika shkollore për notim - Metodat, format dhe instrumentet e notimit - Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit të nxënësve - Përdorimi i informacioneve nga vlerësimi i mësimi
1.5	Aktivitete dhe gara jashtëshkollore	- Vëllimi dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtëshkollore - Mbulimi i nxënësve të gjinive dhe gjuhës të ndryshme mësimore me aktivitete jashtëshkollore - Përfshirja e nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e punës në aktivitetet jashtëshkollore - Gara

SFERA 2: ARRITJET E NXËNËSVE

2.1	Arritjet e nxënësve	- Ndjekja e arritjeve të nxënësve të gjinive dhe gjuhëve të ndryshme mësimore sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave të kualifikimit - Rezultatet e testimeve eksterne - Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në nxënie, nxënësve të talentuar dhe nxënësve me aftësi të kufizuara - Njoftimi i prindërve/kujdestarëve për arritjet e nxënësve
2.2	Masat për përmirësimin e arritjeve	- Rregullsia në mësim - Këshillimi i prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve - Përmirësimi i arritjeve të nxënësve përmes mëimit të rregullta dhe plotësues

SFERA 3: KLIMA SHKOLLORE DHE MARRËDHËNIET NË SHKOLLËN

3.1	Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	- Reputacioni/imazhi i shkollës - Kodi i Sjelljes - Klima shkollore - Sjellja dhe disiplina në shkollë - Pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve
3.2	Barazia dhe drejtësia	- Njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve - Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve
3.3	Marrëdhënie partneriteti me bashkësinë	- Bashkëpunimi i shkollës me prindërit/kujdestarët - Bashkëpunimi me komunën dhe me bashkësinë urbane

3.4	Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit	• Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna • Mbrojtje nga pirja e duhanit, alkooli dhe nga droga • Kualiteti i ushqimit në dispozicion • Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet • Kujdesi për sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve • Kujdesi për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale • Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore • Kujdesi për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve • Dhënia e ndihmës gjatë përzgjedhjes për vazhdimin e arsimit
-----	-------------------------------------	---

SFERA 4: MENAXHIMI, UDHËHEQJA DHE HARTIMI I POLITIKAVE

4.1	Menaxhimi dhe udhëheqja e shkollës	• Menaxhimi i shkollës • Udhëheqja e shkollës • Menaxhimi dhe udhëheqja e resurseve • Udhëheqja e kuadrit • Ndjekja dhe përmirësimi i procesit mësimor
4.2	Qëllimet dhe hartimi i politikës shkollore	• Procedurat për hartimin e politikave shkollore • Rezultatet e planifikimit zhvillimor • Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit të shkollës



SFERA 1: PLANIFIKIMI, MËSIMI DHE NXËNIA

SFERA 1. PLANIFIKIM, MËSIM DHE NXËNIE

NUMRI	INDIKATORI	TEMA
1.1	Planifikimet e mësimdhënësve	- Mbështetja dhe ndjekja e planifikimeve të mësimdhënësve - Shkëmbimi i përvojave dhe informacionet gjatë planifikimit
1.2	Procesi mësimor	- Realizimi i planeve dhe programeve mësimore - Përzgjedhja e lëndëve mësimore - Përzgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve - Ndërveprimi mes mësimdhënësve dhe nxënësve dhe nxënësve mes vete - Realizimi i inkluzionit arsimor - Aktivitete për integrimin ndëretnik në arsim
1.3	Përvoja e nxënësve nga nxënia	- Mjedisi dhe atmosfera për nxënie - Identifikimi dhe plotësimi i nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve
1.4	Notimi si pjesë e mëimit	- Politika shkollore për notim - Metodat, format dhe instrumentet e notimit - Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit të nxënësve - Përdorimi i informacioneve nga vlerësimi i mëimit
1.5	Aktivitete dhe gara jashtëshkollore	- Vëllimi dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtëshkollore - Mbulimi i nxënësve të gjinive dhe gjuhës të ndryshme mësimore me aktivitete jashtëshkollore - Përfshirja e nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e punës në aktivitetet jashtëshkollore - Gara

1.1

PLANIFIKIME TË MËSIMDHËNËSVE

TEMA:

- MBËSHTETJA DHE NDJEKJA E PLANIFIKIMEVE TË MËSIMDHËNËSVE
- SHKËMBIMI I PËRVOJAVE DHE INFORMACIONEVE GJATË PLANIFIKIMIT

dhe nga bashkëpunimi rajonal me shkollat e tjera. Planifikimet te një numër i madh i mësimdhënësve janë përmirësuar si rezultat i shkëmbimit të përvojave dhe përdorimit të përvojave profesionale nga media të ndryshme, nga bashkëpunimi rajonal me shkolla të tjera, etj.

SHUMË MIRË

- Shkolla siguron trajnim me kohë të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë për zbatimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore të planifikimeve të mësimin. Pas trajnimeve të zbatuara, kuadri i trajnuar bën rregullisht diseminacion tek mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët tjerë profesionalë. Nga shërbimi profesional, drejtori dhe/ose personi i emëruar ndiqen planifikimet e mësimdhënësve, ka procedura të përcaktuara për ndjekjen dhe dhënien e mbështetjes për përmirësim. Së paku dy herë në një gjysmëvjetor ndiqen planifikimet e mësimdhënësve nga drejtori, nga bashkëpunëtorët profesionalë dhe/ose nga personat e emëruar nga organet profesionale.
- Mësimdhënësit së paku dy herë në gjysmëvjetor shkëmbejnë përvoja për planifikimet në kuadër të aktiveve profesionale, përdorin përvoja profesionale nga media të ndryshme

PJESËRISHT KËNAQ

- Shkolla siguron trajnime për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë për aplikimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore në planifikimin e mësimin. Diseminacioni nuk bëhet gjithmonë nga trajnimet e zhvilluara për planifikimet e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë. Në fillim të vitit shkollor shqyrtohen planifikimet e mësimdhënësve nga drejtori, nga bashkëpunëtorët profesionalë dhe/ose nga personat e emëruar nga organet profesionale, por nuk ka procedura për dhënien e mbështetjes për përmirësim.
- Mësimdhënësit i bëjnë planifikimet individualisht, ndërsa përdorin përvoja profesionale nga media të ndryshme. Planifikimet te një pjesë e vogël e mësimdhënësve janë përmirësuar si rezultat i përdorimit të përvojave profesionale nga media të ndryshme.

DOKUMENTE

- Planet dhe programet mësimore të miratuara nga MASH
- Standardet Kombëtare për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor

BURIMET E TË DHËNAVE

Programi vjetor i punës së shkollës; planifikime të mësimdhënësve; listat, agjendat dhe raportet nga trajnimet e realizuara; procesverbalet dhe listat e mbledhjeve të aktivave profesionale; anketat me mësimdhënësit; intervistat me drejtorin, bashkëpunëtorët profesionalë; raportet nga bashkëpunëtorët profesionalë për planifikimet e ndjekura.



1.2

PROCESI MËSIMOR

TEMA:

- REALIZIMI I PLANEVE DHE PROGRAMEVE MËSIMORE
- PËRZGJEDHJA E LËNDËVE MËSIMORE
- PËRZGJEDHJA E DETYRAVE, AKTIVITETEVE DHE RESURSEVE
- NDËRVEPRIMI MES MËSIMDHËNËSVE DHE NXËNËSVE DHE NXËNËSVE MES VETE
- REALIZIMI I INKLuzionit ARSIMOR
- AKTIVITETE PËR INTEGRIM NDËRETNËK NË ARSIM

SHUMË MIRË

- Mësimi në mësimin klasor dhe në të gjitha lëndët mësimore realizohet rregullisht dhe në vëllimin e përcaktuar. Në raste të mungesës së mësimdhënësit (pushimi i lindjes, pushimi mjekësor, etj.), mësimi zhvillohet pa probleme me kuadrin përkatës mësimor.
- Aktivitetet dhe lëndët zgjedhore/ të lira janë në përputhje me planet dhe programet mësimore, Doracakun për lëndë të lira zgjedhore në arsimin fillor dhe procedurat e përcaktuara në shkollë, në të cilat janë përfshirë

interesat e nxënësve.¹

- Të gjithë mësimdhënësit, detyrat dhe aktivitetet i përshtatin me nevojat individuale arsimore të nxënësve. Me këtë rast, mësimdhënësit përdorin qasje dhe resurse të ndryshme për nxënie dhe mësim, duke mos u kufizuar vetëm në librat shkollorë dhe literaturën manuale shtesë. Resurset në dispozicion përdoren në mënyrë funksionale duke përdorur qasje moderne në mësimin si: mësimi me përvojë, mësimi përmes projektit, mësimi përmes zgjidhjes së problemeve, mësimi përmes lojës, mësimi përmes hulumtimit, aplikimi i veglave dhe programeve digjitale, etj. Për nxënësit me NVA, përdoren metodat dhe teknikat sipas nevojave të tyre.
- Të gjithë mësimdhënësit sillen me nxënësit në mënyrën që promovon pranimin, respektin, bashkëpunimin dhe mirëkuptimin. Numri më i madh i mësimdhënësve sigurojnë mundësi të barabarta për përfshirje dhe i përfshijnë të gjithë nxënësit gjatë orëve mësimore. Në numrin më të madh të orëve mësimore, ekziston ndërveprimi mes mësimdhënësit dhe nxënësve që shpie drejt arritjes së qëllimeve të orës.

¹ Përfashtim bëjnë shkollat me një numër të vogël nxënësish në të cilat lista e lëndëve zgjedhore, në marrëveshje me nxënësit (respektivisht me prindërit/kujdestarët e tyre), mund të jetë më e kufizuar.

Në numrin më të madh të orëve mësimore, zgjedhja e metodave dhe teknikave të aplikuara mundëson ndërveprimin mes nxënësve. Numri më i madh i nxënësve konsiderojnë se mund të shprehen lirshëm gjatë orëve të mësimi.

- Ekipi inkluziv i shkollës dhe ekipi inkluziv i nxënësit janë formuar me Aktvendim/Vendim të drejtorit të shkollës. Ato përditësohen rregullisht me mbarimin e mandatit ose ndryshimin e mësimdhënësve të nxënësit me NVA. Ekipi inkluziv siguron mbështetje për përpilimin e PIA-s në të gjitha lëndët, në përputhje me rregullativën ligjore. Me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, aktivitetet mësimore/jashtëshkollore realizohet sipas PIA dhe/ose programi të modifikuar sipas rekomandimeve të KNF (Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionalitetit). Shkolla bashkëpunon në mënyrë aktive me qendrën kompetente të resurseve për të avancuar mësimin për nxënësit me aftësi të kufizuara. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë janë të trajnuar për të planifikuar dhe realizuar mësim me nxënës me NVA. Teknologjia asistive që e ka në dispozicion shkolla është në funksion të zhvillimit të nxënësve me NVA. Qasja në shkollë, hapësira në korridore dhe në klasat, tualetet janë përshtatur për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike. Mësimdhënësit vlerësojnë arritjet e nxënësve me NVA në përputhje me qëllimet në planin individual arsimor, në bashkëpunim me ekipin inkluziv të nxënësit.

Shkolla siguron kushte për pjesëmarrjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në aktivitete jashtëshkollore në përputhje me interesat e tyre. Nxënësit me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojë për asistencë personale dhe/ose arsimore identifikohen më kohë dhe dorëzohet kërkesë për mbështetje përkatëse. Kuadri mësimor bashkëpunon me sukses me asistentët arsimorë me qëllim të interesin më të mirë për nxënësin. Ekipi inkluziv punon në orientimin profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

- EISH (Ekipi i Integritetit Shkollor) zbaton planin e veprimit për ndjekjen e realizimit të aktiviteteve për INA të planifikuara në PVPSH, aktivitetet e projektit që janë marrë përmes granteve nga MASH-i dhe organizatat tjera partnere dhe për këtë përgatitë raporte tremujore, gjysmëvjetore dhe vjetore. EISH gjithashtu koordinohet me Komisionin për INA të vetëqeverisjes lokale për zbatimin e aktiviteteve komunale nga Strategjia për INA dhe aktivizëm rinor?² EISH rregullisht i plotëson pyetësorët anketues për nevojat e Komisionit për avancimin e INA-s në MASH, ndërsa kopja e pyetësorit të plotësuar arkivohet në portofolin për INA. Në PVPSH, ku mësimi zhvillohet në dy ose tre gjuhë mësimore, numri më i madh i lëndëve të zgjedhura të lira realizohen me grupe të balancuara “të përziera” të nxënësve në aspektin gjuhësor të gjuhëve të

² Në komunat në të cilat është themeluar komision dhe është miratuar strategji.

ndryshme mësimore, të mësuara nga mësimdhënës që realizojnë mësimin në gjuhët përkatëse mësimore. Shkollat që realizojnë mësim në disa gjuhë mësimore, numrin më të madh të aktiviteteve jashtëshkollore i realizojnë me grupe heterogjene të nxënësve në aspektin gjuhësor. Ka shembuj të orëve të përbashkëta të organizuara mësimore me nxënës që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme mësimore, në përputhje me Udhëzuesin për organizimin e orëve të përbashkëta mësimore.

PJESËRISHT KËNAQ

- Mësimi në mësimin klasor dhe në të gjitha lëndët kryhet në vëllimin e përcaktuar. Shkolla ka vështirësi në gjetjen e një zëvendësimi përkatës në mungesë të mësimdhënësit.
- Shkolla ofron dhe realizon lëndë zgjedhore / të lira për të plotësuar të gjithë fondin e mësimdhënësve me numër të pamjaftueshëm të orëve mësimore.
- Një numër i vogël i mësimdhënësve, detyrat dhe aktivitetet i përshtatin me nevojat individuale arsimore të nxënësve. Në një numër të vogël të orëve mësimore përdoren resurse të ndryshme, si dhe qasje moderne në mësimin.
- Pjesa më e madhe e mësimdhënësve sillen me nxënësit në mënyrën që promovon pranimin, respektin, bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Vetëm një numër i vogël i mësimdhënësve sigurojnë mundësi të barabarta për përfshirje dhe i përfshijnë të gjithë nxënësit gjatë orëve mësimore. Në një numër të vogël të orëve mësimore, ekziston ndërveprimi mes mësimdhënësit dhe nxënësve. Në një numër të vogël të orëve mësimore, zgjedhja e metodave dhe teknikave të aplikuara mundëson ndërveprimin mes nxënësve. Një numër i madh i nxënësve konsiderojnë se mund të shprehen lirshëm gjatë orëve të mësimin.

- Ekipi inkluziv i shkollës nuk është formuar me Aktvendim/Vendim të drejtorit të shkollës, ose nuk është përditësuar gjatë ndryshimit të mësimdhënësve të nxënësit me NVA. Ekipi inkluziv, vetëm me kërkesë të mësimdhënësve, siguron mbështetje për përpilimin e PIA-s. PIA për një pjesë të lëndëve mësimore janë përpiluar në përputhje me rregullativën ligjore. Shkolla bashkëpunon rrallë me qendrën kompetente të resurseve për të avancuar mësimin për nxënësit me aftësi të kufizuara. Një numër i vogël i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë janë të trajnuar për të planifikuar dhe realizuar mësim me nxënës me NVA. Shkolla nuk ka në dispozicion teknologji asistive. Mësimdhënësit vlerësojnë arritjet e nxënësve me aftësi të kufizuara në përputhje me qëllimet në planin individual arsimor, por rrallë bashkëpunojnë me ekipin inkluziv të nxënësit. Një numër i vogël i nxënësve me NVA janë të përfshirë në aktivitete jashtëshkollore.

Qasja në shkollë, hapësira në korridoret dhe në klasat, tualetet nuk janë përshtatur tërësisht me nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara. Nxënësit me aftësi të kufizuara të cilët kanë nevojë për asistencë personale dhe/ose arsimore nuk identifikohen me kohë dhe kërkesat për mbështetje përkatëse dorëzohen me vonesë. Ka raste të bashkëpunimit të pasuksesshëm ndërmjet kuadrit mësimdhënës dhe asistentët arsimorë. Ekipi inkluziv nuk ofron orientimin profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

- EISH ndjekë realizimin e aktiviteteve INA të PVPSH, aktivitetet e projektit të marra përmes granteve nga MASH-i. EISH rregullisht plotëson pyetësorët anketues për nevojat e Komisionit për avancimin e INA-s në MASH. Në shkollat që realizojnë mësim në disa gjuhë mësimore, ka shembuj të aktiviteteve të realizuara jashtëshkollore me grupe të balancuara gjuhësore heterogjene të nxënësve.

BURIMET E TË DHËNAVE

Programi vjetor i punës së shkollës; orari i orëve të mësimi; e-ditar; evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik; listat dhe raportet e trajnimeve të realizuara; procesverbalet e mbledhjeve të aktiveve profesionale; anketat me mësuesit; studentët, prindërit; diskutimet në grupe fokusi me nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit; intervistat me drejtorin, bashkëpunëtorët profesionalë; raportet nga vizitat në orët mësimore; zgjidhjet për ekip inkluziv të shkollës; PIA të përpiluara dhe programe të modifikuara për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore; procesverbalet e takimeve të ekipeve shkollore për inkluzion dhe ekipe inkluzive për nxënës; raportet dhe procesverbalet e ekipeve të integritit shkollore (EISH), raportet e aktiviteteve të realizuara për integrim ndëretnik; materialet nga procedura për përcaktimin e lëndëve dhe aktiviteteve zgjedhore /të lira zgjedhore; planifikimet për lëndë zgjedhore.

DOKUMENTE

- Koncepti për arsimin fillor (MASH/BZHA, 2020)
- Koncepti për arsimin inkluziv (BZHA, 2020)
- Udhëzues për lëndët e lira zgjedhore në arsimin fillor (DBE, 2021)
- Udhëzuesi i punës së ekipit inkluziv shkollore (BZHA, 2018)
- Udhëzues për lëndët e lira zgjedhore (BZHA, 2021)
- Udhëzim për organizimin e orëve të përbashkëta mësimore (QMEQ, 2021)

1.3

PËRVOJAT E NXËNËSVE NGA NXËNIA

TEMA:

- ▶ MJEDISI DHE ATMOSFERA PËR NXËNIE
- ▶ IDENTIFIKIMI DHE PLOTËSIMI I NEVOJAVE TË NDRYSHME ARSIMORE TË NXËNËSVE

SHUMË MIRË

- Nxënësit dhe prindërit e përjetojnë shkollën si një mjedis të sigurt, stimulues, inkluziv, interkulturore dhe motivues, që nxitë interesin për nxënie. Nxënësit në shkollë kanë qasje në materiale të ndryshme për nxënie. Nxënësit konsiderojnë se mënyra në të cilën mësohet në një numër më të madh të orëve në shkollë është interesante dhe përmbajtjet që u transmetohen atyre i aftësojnë për të zgjidhur problemet në jetën reale dhe për pjesëmarrje qytetare. Gjatë orëve të mësimi, numri më i madh i nxënësve nxiten që të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe kritike, të bëjnë pyetje dhe të nxjerrin konkluzione për atë që e mësojnë. Mësimdhënësit bëjnë komente afirmative në lidhje me aktivitetet e nxënësit, ndërsa nuk i shprehin anët e dobëta të nxënësve para nxënësve të tjerë. Mësimdhënësit përdorin mënyra të ndryshme për të motivuar nxënësit.

- Kuadri mësimor dhe bashkëpunëtorët profesionalë identifikojnë sistematikisht nevojat individuale arsimore të nxënësve. Në procesin e nxënies, ndërmarrin aktivitete për plotësimin e nevojave dhe për të hequr pengesat gjatë nxënies. Numri më i madh i mësimdhënësve, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesionalë, përdorin teknika të ndryshme interaktive në procesin e mësimdhënies, me çka u japin mundësi nxënësve me nevoja të ndryshme arsimore për të arritur qëllimet e planifikuara.

PJESËRISHT KËNAQ

- Nxënësit dhe prindërit e përjetojnë shkollën si një mjedis të sigurt, por pjesërisht stimulues, inkluziv, interkulturore dhe motivues. Nxënësit nuk kanë qasje të plotë në materiale të ndryshme për nxënie. Nxënësit konsiderojnë se mënyra në të cilën mësohet në një numër të vogël të orëve në shkollë është interesante. Gjatë orëve të mësimi, një numër i vogël i nxënësve nxiten që të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe kritike, të bëjnë pyetje dhe të nxjerrin konkluzione për atë që e mësojnë. Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin mënyra të ndryshme për të motivuar nxënësit.

- Kuadri mësimor dhe bashkëpunëtorët profesionalë nuk e bëjnë sistematikisht identifikimin e nevojave dhe pengesave në procesin e nxënies së nxënësve. Në procesin e nxënies, ndërmarrin aktivitete për plotësimin e nevojave dhe/ose për të hequr pengesat gjatë nxënies. Një numër i vogël i mësimdhënësve, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesionalë, përdorin teknika të ndryshme interaktive në procesin e mësimdhënies, prandaj një pjesë e nxënësve me nevoja të ndryshme arsimore nuk mund t'i arrijnë qëllimet e planifikuara.

BURIMET E TË DHËNAVE

Anketë me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit; bisedë në grupe fokusi me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit; bisedë me shërbimin profesional; qasje në dosjet e nxënësve; qasje në evidencën e bashkëpunëtorëve profesionalë.



1.4

NOTIMI SI PJESE E MËSIMIT

TEMA:

- POLITIKA SHKOLLORE E NOTIMIT
- METODAT, FORMAT DHE INSTRUMENTET E NOTIMIT
- KOEFICIENTI I VAZHDIMËSISË SË SUKSESIT TË NXËNËSVE
- PËRDORIMI I INFORMACIONEVE NGA NOTIMI NË MËSIM

përparimin përparimin e nxënësve. Nxënësit përfshihen në notimin (përmes vetënotimit, notimit të ndërsjellë, ndërtimit të kriterëve, udhëheqjes së portofoleve, etj.). Instrumentet e notimit avancohen në bashkëpunim me shërbimin profesional.

- Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit, në periudhën e tretë të arsimit nga tri vitet vijuese paraprake, i përlogaritur si raport i suksesit mesatar të shkollës në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit është më i madh se 0,9.
- Mësimdhënësit i përdorin të gjitha informacionet që i kanë marrë nga notimi në mënyrë që t'i përmirësojnë planifikimet dhe realizimin e mësimin. Të gjithë mësimdhënësit u japin rregullisht informacione kthyes nxënësve për punën e tyre, diskutojnë me nxënësit për përparimin dhe arritjet e tyre dhe sipas nevojës i përfshijnë në mësimin shtesë ose plotësues.

SHUMË MIRË

- Shkolla zbaton politikë të paracaktuar të notimit, duke përfshirë edhe kodin e notimit, qëllimi kryesor i të cilit është të mbështesë nxënien e secilit nxënës. Shkolla në nivelin e aktiveve profesionale ka kriterë të ndërtuara të notimit, në përputhje me standardet kombëtare të arritjeve. Kriteret e harmonizuara në aktivet profesionale, mësimdhënësit i përdorin për të notuar nxënësit dhe me to janë të njoftuar nxënësit dhe prindërit. Numri më i madh i mësimdhënësve aplikojnë notim formativ. Notimi formativ dhe sumativ është publik dhe transparent për nxënësit.
- Mësimdhënësit përdorin metoda, forma dhe instrumente të shumëllojshme për të notuar dhe ndjekur vazhdimisht

PJESËRISHT KËNAQ

- Shkolla zbaton politikë të dakorduar të notimit, qëllimi themelor i së cilës është të mbështesë nxënien e secilit nxënës. Shkolla në nivelin e aktiveve profesionale ka kriterë të ndërtuara të notimit, të harmonizuara me standardet kombëtare të arritjeve, por nxënësit dhe

- prindërit nuk janë të njoftuar me kriteret e notimit. Një numër i vogël i mësimdhënësve zbatojnë notim formativ. Notimi formativ dhe sumativ te një numër i vogël i mësimdhënësve është publik dhe transparent për nxënësit.
- Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin metoda, forma dhe instrumente të shumëllojshme për të notuar dhe ndjekur përparimin e nxënësve. Në një numër të vogël të lëndëve mësimore, nxënësit përfshihen në notimin (përmes vetënotimit, notimit të ndërsjellë, ndërtimit të kriterëve, udhëheqjes së portofoleve, etj.). Instrumentet e notimit nuk avancohen në bashkëpunim me shërbimin profesional.
- Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit, në periudhën e tretë të arsimit nga tri vitet vijuese paraprake, i përlogaritur si raport i suksesit mesatar të shkollës në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit është më i madh se 0,6, e më i vogël se 0.7.
- Një numër i vogël i mësimdhënësve i përdorin të gjitha informacionet që i kanë marrë nga notimi në mënyrë që t'i përmirësojnë planifikimet dhe realizimin e mësimi. Ata diskutojnë me nxënësit për përparimin dhe arritjet e tyre, u japin informacion kthyes.

DOKUMENTE

- Standarde kombëtare për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor (BZHA, 2021)
- Rregullore për organizimin dhe mënyrën e zbatimit të mësimi shtesë dhe plotësues në shkollat fillore (MASH, 2019 dhe 2020-plotësim)
- Kritere për notimin e arritjeve të nxënësve (BZHA)

BURIMET E TË DHËNAVE

Program për punën e shkollës; orar për mësim shtesë dhe plotësues; lista të nxënësve të përfshirë në mësimin shtesë dhe plotësues; rregullore për notim dhe avancim të nxënësve; rregullore interne për notim; qasje në evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik; instrumente të përdorura për notim; shembuj të punimeve të notuara të nxënësve; procesverbale nga aktivet profesionale, këshillat e mësimdhënësve; anketa/intervista me nxënësit dhe mësimdhënësit, prindërit; instrumentet për mënyra të individualizuara të kontrollit.

1.5

AKTIVITETE DHE GARA JASHTËSHKOLLORE

TEMA:

- VËLLIMI I LLOJLLOJSHMËRISË SË AKTIVITETEVE DHE GARAVE JASHTËSHKOLLORE
- PËRFSHIRJA E NXËNËSVE ME AKTIVITETE JASHTËSHKOLLORE
- PËRFSHIRJA E NXËNËSVE NË PËRZGJEDHJEN DHE PLANIFIKIMIN E AKTIVITETEVE JASHTËSHKOLLORE
- GARA

Nxënësit përfshihen në aktivitete jashtëshkollore sipas zgjedhjes personale, përmes procedurës transparente. Nxënësit janë të përfshirë në përgatitjen e programeve për aktivitete jashtëshkollore.

- Shkolla organizon gara shkollore për seleksionimin e nxënësve për gara në nivel më të lartë. Nxënësit, me ndihmën dhe mbështetjen e shkollës dhe të mësimdhënësve, marrin pjesë në gara të sferave të ndryshme që organizohen në nivel komunal, rajonal, shtetëror (nga shoqatat e akredituara të mësimdhënësve) ose ndërkombëtar, si dhe aktivitetet tjera me karakter garues.

SHUMË MIRË

- Shkolla planifikon dhe realizon aktivitete të llojllojshme jashtëshkollore që i reflektojnë nevojat dhe interesat e nxënësve.
- Të gjithë nxënësit janë të përfshirë së paku në një aktivitet jashtëshkollor. Në shkollë, me nxënësit e ciklit të tretë arsimor, janë realizuar aktivitete shoqërore humanitare, në kuadër të aktiviteteve jashtëshkollore.
- Numri më i madh i nxënësve janë të njoftuar me aktivitetet jashtëshkollore që ofrohen në shkollë. Në shkollë realizohen aktivitete jashtëshkollore të propozuara nga nxënësit.

PJESËRISHT KËNAQ

- Shkolla planifikon, por nuk i realizon tërësisht aktivitete e planifikuar jashtëshkollore. Aktivitetet jashtëshkollore janë kufizuar sipas llojit dhe i reflektojnë në mënyrë të pamjaftueshme nevojat dhe interesat e nxënësve.
- Një numër i vogël nxënësish janë të përfshirë së paku në një aktivitet jashtëshkollor. Në shkollë, me nxënësit e ciklit të tretë arsimor, janë realizuar aktivitete shoqërore humanitare, në kuadër të aktiviteteve jashtëshkollore.

- Një numër i vogël i nxënësve janë të njoftuar me aktivitetet jashtëshkollore që ofrohen në shkollë. Rekomandimet e mësimdhënësve janë vendimtare në përzgjedhjen e aktiviteteve jashtëshkollore, si dhe në planifikimin e përmbajtjeve të aktiviteteve.
- Shkolla nuk organizon gara shkollore për seleksionimin e nxënësve për gara në nivel më të lartë. Ka mbështetje të pjesërishtme nga mësimdhënësit, për të marrë pjesë në gara të sferave të ndryshme që organizohen në nivel komunal, rajonal, shtetëror (nga shoqatat e akredituara të mësimdhënësve), si dhe aktivitetet tjera me karakter garues.


BURIMET E TË DHËNAVE

Programi vjetor i punës; programi për aktivitete jashtëshkollore; raport nga ekskursionet e realizuara; evidenca dhe dokumentacioni pedagogjik; diploma, mirënjohje, lëvdata nga pjesëmarrja në manifestime dhe gara; intervista/anketa me mësimdhënësit, prindër, nxënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë për aktivitete jashtëshkollore; procesverbale nga aktivitetet profesionale dhe bashkësia e nxënësve; lista e nxënësve të përfshirë në aktivitete jashtëshkollore; qasje në faqen e internetit, në gazetatat, programin e radios, rrjetet sociale, etj.

DOKUMENTE

- Koncepte për aktivitete jashtëshkollore në arsimin fillor (BZHA, 2020)
- Rregullore për mënyrën dhe kriteret më të afërta të organizimit dhe realizimit të garave të nxënësve në lëndë të caktuara në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin fillor (MASH, 2019 dhe 2020-plotësim)





SFERA 2: ARRITJET E NXËNËSVE

SFERA 2: ARRITJET E NXËNËSVE

NUMRI	INDIKATORI	TEMA
2.1	Arritjet e nxënësve	- Ndjekja e arritjeve të nxënësve të gjinive dhe gjuhëve të ndryshme mësimore sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave të kualifikimit - Rezultatet e testimeve eksterne - Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në nxënie, nxënësve të talentuar dhe nxënësve me aftësi të kufizuara - Njoftimi i prindërve/kujdestarëve për arritjet e nxënësve
2.2	Masat për përmirësimin e arritjeve	- Rregullsia në mësim - Këshillimi i prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve - Përmirësimi i arritjeve të nxënësve përmes mësimit të rregullta dhe plotësues

2.1 ARRITJET E NXËNËSVE

TEMA:

- NDJEKJE E ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË GJINISË DHE GJUHËS SË NDRYSHME TË MËSIMIT SIPAS LËNDËVE MËSIMORE DHE SIPAS PERIUDHAVE TË KLASIFIKIMIT
- REZULTATE NGA TESTIMET EKSTERNE
- IDENTIFIKIMI DHE MBËSHTETJA E NXËNËSVE ME VËSHTIRËSI NË NXËNIEN, TË NXËNËSVE TË TALENTUAR DHE TË NXËNËSVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR
- NJOFTIM TË PRINDËRVE/ KUJDESTARËVE PËR ARRITJET E NXËNËSVE

SHUMË MIRË

- Shkolla përzgjedhë, përdorë dhe analizon të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimit, nga të gjitha lëndët mësimore, për të gjitha periudhat e kualifikimit. Sipas secilës periudhë të kualifikimit, me propozim të Këshillit të mësimdhënësve, Këshillit shkollor miraton plan të veprimit me aktivitete për përmirësimin e arritjeve dhe sipas tremujorit i shqyrton arritjet nga Plani i veprimit. Pjesëmarrja dhe arritjet në aktivitete jashtëshkollore ndiqet dhe evidentohet vazhdimisht.

- Rezultatet që janë marrë nga testimet shtetërore, studimet/raportet për vlerësime ndërkombëtare analizohen dhe mësimi përmirësohet në mënyrë përkatëse.
- Nxënësit me vështirësi në nxënien, nxënësit e talentuar, si dhe nxënësit me aftësi të kufizuar identifikohen në përputhje me procedurat e përcaktuara. Nxënësit marrin mbështetje të vazhdueshme për përmirësimin e arritjeve.
- Shkolla ka sistem të përcaktuar për njoftimin e prindërve për përparimin e fëmijëve të tyre dhe e zbaton në mënyrë të përpiktë. Prindërit/kujdestarët marrin informacione për arritjet e nxënësve pas çdo periudhe të kualifikimit. Prindërit kanë mundësi të njoftohen me arritjet e fëmijës së tyre përmes e-ditarit që udhëhiqet rregullisht.


PJESËRISHT KËNAQ

- Shkolla përzgjedhë, përdorë dhe analizon të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimit, nga të gjitha lëndët mësimore, për të gjitha periudhat e kualifikimit, por nuk ndërmerr aktivitete për përmirësim. Pjesëmarrja dhe arritjet në aktivitete jashtëshkollore evidentohet.

- Rezultatet që janë marrë nga testimet shtetërore, studimet/raportet për vlerësime ndërkombëtare mblidhen, por nuk analizohen.
- Shkolla i dallon nxënësit e talentuar, nxënësit që kanë vështirës në nxënien, si dhe nxënësit me pengesa në zhvillimin, por nuk e ndjekë me rregullt përparimin e tyre. Nxënësit kohë pas kohe marrin mbështetje për përmirësimin e arritjeve.
- Prindërit janë të informuar për mundësitë për të komunikuar me shkollën për përparimin e fëmijëve të tyre, por nuk janë të nxitur që ta bëjnë këtë. Prindërit/kujdestarët marrin informacione për arritjet e nxënësve pas çdo periudhe të kualifikimit. E-ditari nuk udhëhiqet rregullisht dhe prandaj prindërit nuk kanë mundësi të informohen rregullisht për arritjet e fëmijës së tyre.

BURIMET E TË DHËNAVE

E-ditari; procesverbalet nga mbledhjet prindërore, analiza të arritjeve sipas kriterëve të ndryshme dhe periudha kualifikuese dhe planit të veprimit për përmirësim; analiza e rezultateve nga testimet eksterne; anketa me nxënës, mësimdhënës, prindër; intervista me bashkëpunëtorë profesionalë, drejtor.



2.2

MASA PËR PËRMIRËSIMIN E ARRITJEVE

TEMA:

- RREGULLSIA NË MËSIM
- KËSHILLIM I PRINDËRVE/KUJDESTARËVE DHE NXËNËSVE
- PËRMIRËSIM I ARRITJEVE TË NXËNËSVE PËRMES MËSIMIT TË RREGULLT DHE PLOTËSUES

SHUMË MIRË

- Shkolla e ndjekë në mënyrë sistematike rregullsinë e nxënësve, analizon arsyet për mungesë nga mësimi dhe ndërmerr aktivitete konkrete. Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët, institucionet (MPPS, qendrat për punë sociale etj.), vetëqeverisjen lokale dhe me organizatat qytetare në mënyrë që të rrisë rregullsinë e nxënësve në mësimin. Numri mesatar i mungesave të paarsyeshme midis dy evaluimeve integrale është më pak se pesë për nxënë. Shkolla ndërmerr masa të veçanta për ndjekjen e rregullt të mësimit nga nxënësit e kategorive të rrezikuara, që japin rezultate.
- Shkolla i realizon këshillimet e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, për çka udhëheqë dokumentacion të rregullt, i njofton institucionet kompetente, bën analizë të rezultateve

nga këshillimi dhe e ndjekë përmirësimin e rregullsisë, suksesit dhe sjelljes së nxënësve. Këshillimet e prindërve/kujdestarëve rezultojnë me përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Këshillimet e nxënësve, në numrin më të madh kontribuojnë në përmirësimin e suksesit, rregullsisë dhe sjelljes.

- Numri më i madh i mësimdhënësve përdorin metoda, teknika, strategji në mësimin për përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Gjatë vitit, është evident ndryshimi në realizimin e mësimit për përmirësimin e arritjeve. Gjatë gjithë vitit shkollor, shkolla realizon mësim plotësues nga të gjitha lëndët për të cilat nxënësit kanë vështirësi në nxënien, si dhe mësim të diferencuar. Shkolla, në nivel mujor, përpilon orar për mësim plotësues dhe e thekson në vend të dukshëm në shkollë. Shkolla bën analizë dhe ka dëshmi se mësimi plotësues dhe i diferencuar kontribuojnë në përmirësimin e arritjeve.

PJESËRISHT KËNAQ

- Shkolla e ndjekë rregullsinë e nxënësve, por aktivitetet që i ndërmerr për zvogëlimin e numrit të mungesave nuk janë të bazuara në analiza. Bashkëpunimi me prindërit për rritjen e rregullsisë së nxënësve përmes mbajtjes

së mbledhjeve të përbashkëta prindërore. Numri mesatar i mungesave të paarsyeshme midis dy evaluimeve integrale ndërmjet 8 dhe 12 për nxënës. Masat që i ndërmerr shkolla për ndjekje të rregullt të mësimit nga nxënësit e kategorive të rrezikuara nuk japin rezultate.

- Shkolla i realizon këshillimet e prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve, bën analizë të rezultateve nga këshillimi dhe e ndjekë përmirësimin e rregullsisë, suksesit dhe sjelljes së nxënësve, por nuk i njofton institucionet kompetente. Këshillimet e prindërve/kujdestarëve nuk rezultojnë me përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Këshillimet e nxënësve, në numrin më të madh nuk kontribuojnë në përmirësimin e suksesit, rregullsisë dhe sjelljes.
- Një numër i vogël i mësindhënësve përdorin metoda, teknika, strategji në mësimin për përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Gjatë vitit nuk ka ndryshime në realizimin e mësimit në drejtim të përmirësimit të arritjeve. Shkolla, në nivel mujor, përpilon orar për mësim plotësues, por e realizon nga/ose në fund të vitit shkollor, vetëm në lëndë të caktuara mësimore. Shkolla nuk analizon rezultatet nga mësimi plotësues dhe/ose i diferencuar nga aspekti i kontributit drejt arritjeve.

BURIMET E TË DHËNAVE

Procesverbale nga këshillime të prindërve dhe nxënësve; orar dhe listë të mësimit plotësues dhe shtesë; E-ditari; raporte për bashkëpunim me faktorë të ndryshëm për përmirësimin e arritjeve.





SFERA 3: KLIMA SHKOLLORE DHE MARRËDHËNIET NË SHKOLLËN

SFERA 3: KLIMA SHKOLLORE DHE MARRËDHËNIET NË SHKOLLËN

NUMRI	INDIKATORI	TEMA
3.1	Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	• Reputacioni/imazhi i shkollës • Kodi i Sjelljes • Klima shkollore • Sjellja dhe disiplina në shkollë • Pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve
3.2	Barazia dhe drejtësia	• Njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve • Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve
3.3	Marrëdhënie partneriteti me bashkësinë	• Bashkëpunimi i shkollës me prindërit/kujdestarët • Bashkëpunimi me komunën dhe me bashkësinë urbane
3.4	Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit	• Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna • Mbrojtje nga pirja e duhanit, alkooli dhe nga droga • Kualiteti i ushqimit në dispozicion • Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet • Kujdesi për sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve • Kujdesi për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale • Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore • Kujdesi për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve • Dhënia e ndihmës gjatë përzgjedhjes për vazhdimin e arsimit

3.1

KLIMA SHKOLLORE DHE MARRËDHËNIET NË SHKOLLËN

TEMA:

- REPUTACION /IMAZH I SHKOLLËS
- KODI I SJELLJES
- KLIMA SHKOLLORE
- SJELLJE DHE DISIPLINË NË SHKOLLË
- PJESËMARRJE E NXËNËSVE NË VENDIMMARRJE DHE ZGJIDHJE TË PROBLEMEVE

SHUMË MIRË

- Shkolla dallohet në mjedisin lokal si shkollë që promovon arritje të larta, rregullsi, disiplinë të nxënësve dhe bashkëpunim me bashkësinë lokale. Shkolla zbaton aktivitete jashtëshkollore sipas të cilave dallohet në mjedisin. Shkolla, për afirmimin e aktiviteteve jashtëshkollore, i përdorë në mënyrë përkatëse mediat e ndryshme (p.sh. gazeta shkollore, radioja shkollore, faqja e internetit, rrjete sociale, këndi i nxënësve, etj.). Shkolla ka ndërtuar sistem të promovimit të arritjeve të të gjithë nxënësve në kuadër të shkollës dhe në mjedisin më të gjerë lokal.
- Shkolla ka kod të sjelljes, në të cilin janë vendosur parimet dhe rregullat e sjelljes në shkollë të të gjitha strukturave.

Kodi është përpiluar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve e të gjithë interesuarve për jetën në shkollë, ndërsa aprovimi i tij është përmes procedurës transparente. Shkolla ka procedura të shkruara për veprim në rast të shkeljes së parimeve dhe rregullave të sjelljes, të përcaktuara me kodin dhe procedurat e tilla i zbaton në praktikë dhe ka shembuj nga zbatimi. Shkolla ka vendosur procedura të rregullta për përditësimin e kodit të sjelljes, që përfshin të gjitha palët e interesuara.

- Në mesin e të gjithë pjesëmarrësve në jetën shkollore ekziston respekti i ndërsjellë dhe përfshirja në aktivitetet në shkollë. Në shkollë ekziston bashkëpunim profesional ndërmjet të punësuarve. Kuadri udhëheqës, mësimdhënës dhe të punësuarit tjerë kontribuojnë për mirëmbajtjen e atmosferës pozitive në shkollë. Të punësuarit i udhëzojnë nxënësit që të kujdesen për njëri-tjetrin dhe për shkollën. Të gjithë nxënësit ndjehen të sigurt dhe të pranuar nga të rriturit dhe nga nxënësit tjerë në shkollë. Në shkollë nuk ka kërcënime, gjuhë të urrejtjes, provokime, ofendime dhe/ose grafitë me porosi negative. Mjedisi për nxënie i motivon nxënësit që të vendosin qëllime më të larta.
- Shkolla ka rend shtëpiak, që e respektojnë nxënësit dhe të punësuarit. Ka atmosferë pune gjatë mësimin dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

Të punësuarit kujdesen vazhdimisht për sjelljen e nxënësve gjatë pushimeve, pranimit të nxënësve dhe largimin e tyre nga shkolla, në përputhje me programin e zgjeruar të shkollës. Shkolla e zbaton rregulloren për shqiptimin e masave pedagogjike dhe ekipi për mbështetje punon për tejkalimin e problemit për shkak të cilit është shqiptuar masa pedagogjike.

- Në shkollë funksionon Parlamenti i nxënësve që e reflekton përbërjen etnike të shkollës (në shkolla në më shumë gjuhë mësimore) dhe avokati i nxënësve. Nxënësit janë informuar me kohë dhe plotësisht nga përfaqësuesi i Parlamentit të nxënësve për gjëra që janë në interes të tyre. Nxënësit, përmes Parlamentit të nxënësve marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve dhe miratimin e konkluzioneve. Parlamenti i nxënësve propozon dhe zbaton aktivitete për përmirësimin e punës së shkollës. Ekzistojnë së paku pesë iniciativa të realizuara të Parlamentit të nxënësve. Nxënësit anëtarë të parlamentit të nxënësve ftohen dhe marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e këshillit shkollor.

PJESËRISHT KËNAQ

- Shkolla jorregullisht ndërmerr aktivitete për t'i promovuar arritjet e nxënësve dhe bashkëpunimin me bashkësinë lokale. Shkolla nuk është dalluar në mjedisin sipas aktiviteteve jashtëshkollore, ndërsa aktivitetet që i

zbaton nuk i promovon përmes mediave shkollore.

- Shkolla ka kodeks të sjelljes, në të cilën janë vendosur parimet dhe rregullat e sjelljes në shkollë të të gjitha strukturave. Në përpilimin e kodit kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjithë interesuarve për jetën në shkollë. Shkolla ka procedura të shkruara për veprim në rast të shkeljes së parimeve dhe rregullave të sjelljes, por nuk ka shembuj nga zbatimi në praktikë. Shkolla nuk praktikon përditësimin e përmbajtjes së kodit të sjelljes.
- Në shkollë ka bashkëpunim ndërmjet të punësuarve, nxënësve dhe të involvuarve tjerë në procesin edukativo-arsimor, por ekzistojnë dëshmi për marrëdhënie të prishura ndërmjet individëve. Kuadri udhëheqës, mësimdhënës dhe të punësuarit tjerë nuk janë të qëndrueshëm në përpjekjet e tyre për të siguruar atmosferë pozitive në shkollë. Ka raste kur sjellja e tyre me nxënësit, të punësuarit tjerë, prindërit dhe me vizitorët e shkollës e prishë atmosferën pozitive në shkollë. Nuk u kushtohet vëmendje e mjaftueshme bashkëpunimit të ndërsjellë dhe kujdesit të nxënësve për njëri-tjetrin dhe për shkollën. Ka nxënës që nuk ndjehen të pranuar nga të rriturit dhe/ose nga nxënësit tjerë në shkollë. Në shkollë ka raste të kërcënimeve, gjuhë të urrejtjes, provokime, ofendime dhe/ose grafitë me porosi negative. Mjedisi për nxënie nuk i motivon nxënësit që të vendosin qëllime më të larta dhe pritjet e tyre nga vetja janë modeste.


- Shkolla ka rend shtëpiak, por ekzistojnë raste të shkeljes së të njëjtit. Në një pjesë të vogël të orëve është prishur atmosfera e punës që e rekomandon mësimi/aktivitetet jashtëshkollore. Ka shembuj të përballjes joadekuate me problemet që kanë të bëjnë me disiplinën. Shkolla e zbaton në mënyrë joadekuate rregulloren për shqiptimin e masave pedagogjike dhe ekipi për përfshihet rrallë në përballjen me problemet.
- Në shkollë është formuar Parlamenti i nxënësve. Një pjesë e vogël e nxënësve janë të informuar nga përfaqësuesi i Parlamentit të nxënësve për gjërat që janë në interesin e tyre dhe nuk kanë mundësi të marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve dhe miratimin e konkluzioneve. Parlamenti i nxënësve propozon dhe zbaton aktivitete për përmirësimin e punës së shkollës. Ekzistojnë deri dy iniciativa të realizuara të Parlamentit të nxënësve. Nxënësit anëtarë të parlamentit të nxënësve ftohen dhe marrin pjesë në raste të rralla në mbledhjet e këshillit shkollor.

BURIMET E TË DHËNAVE

Kodeksi i sjelljes; anketa/intervista me mësimdhënësit, prindërit dhe me nxënësit; evidencë pedagogjike për masa të shqiptuara pedagogjike; statuti i shkollës; rendi shtëpiak i shkollës; lëvdata, çmime, mirënjohje etj.; artikuj për shkollën në media kombëtare dhe lokale dhe në rrjete sociale; aktvendim për formimin e parlamentit të nxënësve dhe zgjedhjen e avokatit të nxënësve; programi dhe rregullorja për punën e parlamentit të nxënësve dhe avokatit të nxënësve; dosje e parlamentit të nxënësve (programi për punë, procesverbale, vendime, raporte nga iniciativat e realizuara të nxënësve).

DOKUMENTE

- Rregullore për shqiptimin e masave pedagogjike
- Doracak për pjesëmarrje të nxënësve, organizim të nxënësve dhe mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në arsimin fillor (Koalicioni TANI, 2019)



3.2 BARAZI DHE DREJTËSI

TEMA:

- ▶ NJOHJE DHE RESPEKTIM I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE
- ▶ TRAJTIM I BARABARTË DHE I DREJTË I TË GJITHË NXËNËSVE

SHUMË MIRË


- Në shkollën, avokati i nxënësve kujdeset për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të nxënësve dhe realizon aktivitete për njoftimin e nxënësve me kompetencat e tij në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Të gjithë të punësuarit në shkollë i dinë dhe i respektojnë të drejtat e fëmijëve. Shkolla organizon aktivitete me një pjesë të prindërve/kujdestarët në mënyrë që t'i njoftojë me të drejtat e fëmijëve. Numri më i madh i nxënësve konsideronë se të drejtat e tyre respektohen.
- Shkolla promovon trajtim të barabartë dhe të drejtë ndaj të gjithë nxënësve. Nxënësit dinë të dallojnë trajtimin e pabarabartë dhe ku të drejtohen. Shkolla reagon me kohë dhe në mënyrë përkatëse ndaj ankesave nga nxënësit për trajtim të pabarabartë. Të gjithë nxënësit kanë qasje dhe janë të përfshirë në aktivitetet shkollore.

PJESËRISHT KËNAQ

- Në shkollë është zgjedhur avokati i nxënësve, por nuk ka aktivitete të realizuara për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të nxënësve. Një numër i vogël i të punësuarve në shkollë nuk i respektojnë të drejtat e fëmijëve. Shkolla ndërmerr aktivitete për t'i njoftuar prindërit me të drejtat e fëmijëve. Një numër i madh i nxënësve konsiderojnë se të drejtat e tyre nuk respektohen.
- Shkolla i promovon barazinë dhe drejtësinë si vlera themelore në të gjitha dokumentet e saj të shkruara, por nuk ka zhvilluar mekanizma me të cilat siguron respektimin e tyre në marrëdhëniet ndërmjet të gjitha strukturave që marrin pjesë në jetën shkollore. Në aktivitetet e shkollës nuk janë të përfshirë përfaqësuesit e grupeve të marginalizuara/rrezikuara.

BURIMET E TË DHËNAVE

Anketa dhe bisedime me nxënës, prindër, mësimdhënës, shërbimi profesional, raporte nga aktivitetet e zbatuara për njoftim me të drejtat e fëmijëve; procesverbale nga aktivitetet e parlamentit të nxënësve dhe avokatit të nxënësve (p.sh. numri i parashtrësve dhe mënyra e zgjidhjes); struktura e paraleleve; procesverbale nga puna e EISH-së – Ekipi për Integrim Shkollor; ditari për punën e bashkëpunëtorëve profesionalë; plani operativ për orë mësimore; procesverbale nga këshilli i mësimdhënësve; kritere dhe procedura për përzgjedhjen e nxënësit të gjeneratës.



3.3

RAPORTI I PARTNERITETI ME BASHKËSINË

TEMA:

- ▶ BASHKËPUNIM I SHKOLLËS ME PRINDËRIT/KUJDESTARËT
- ▶ BASHKËPUNIMI ME KOMUNËN DHE BASHKËSINË URBANE

SHUMË MIRË


- Informacionet që kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e punës së shkollës u janë të arritshme prindërve në formë të shkruar dhe/ose elektronike. Shkolla ndërmerr aktivitete të planifikuara mirë për përfshirjen e prindërve në përmirësimin e punës edukativo-arsimore të shkollës në të gjitha nivelet. Ekziston dokumentacion i shkruar për ide të pranuar dhe realizuara nga prindërit/kujdestarët për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor në shkollë. Mendimet dhe qëndrimet e prindërve/kujdestarëve respektohen dhe ndikojnë në vendime të caktuara që merren në shkollën.
- Shkolla është e përfshirë në mënyrë aktive në jetën e komunës dhe bashkësisë urbane përmes zbatimit të projekteve të përbashkëta, aktiviteteve dhe organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje me interes të shkollës dhe bashkësisë.

PJESËRISHT KËNAQ

- Informacionet që kanë të bëjnë me punën e shkollës nuk janë të mjaftueshëm të detajuara dhe/ose mjaft të qarta për prindërit. Shkolla e pranon mbështetjen nga prindërit të cilët me vetiniciativë duan të përfshihen në jetën dhe punën e shkollës, por është i vogël numri i aktiviteteve që shkolla i ndërmerr për përfshirjen e prindërve. Nuk ka praktikë që prindërit të japin ide për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor në shkollë. Mendimet dhe qëndrimet e prindërve/kujdestarëve në raste të rralla ndikojnë në vendime të caktuara që kanë të bëjnë me shkollën.
- Shkolla realizon bashkëpunim me komunën dhe bashkësinë urbane vetëm në kuadër të detyrimeve formale ligjore dhe ekzistojnë një numër i vogël i shembujve të projekteve dhe ngjarjeve të përbashkëta.

BURIMET E TË DHËNAVE

Raport për punën e shkollës (gjysmëvjetor, vjetor); procesverbale nga këshilli i prindërve dhe mbledhjet prindërore; anketa dhe intervista me drejtorin, prindërit, mësimdhënësit dhe me bashkëpunëtorët profesionalë; anketë/intervistë me përfaqësues të bashkësisë lokale; statuti i shkollës; faqja e internetit e shkollës; marrëveshje dhe memorandume për bashkëpunim me komunën dhe organizata/institucione të ndryshme; raport nga aksionet e organizuara, tribuna, debate, ligjërata me prindërit dhe me përfaqësuesit e bashkësisë lokale; dokumentacion për sponsorizime dhe donacione të pranuar.



3.4 KUJDES TË PËRGJITHSHËM PËR NXËNËSIT

TEMA:

- PARANDALIM NGA DHUNA
- MBROJTJA NGA PIRJA E DUHANIT, ALKOOLIT DHE NGA DROGA
- KUALITETA E USHQIMIT NË DISPOZICION
- HIGJENË DHE MBROJTJE NGA SËMUNDJET
- KUJDES PËR SIGURINË E NXËNËSVE DHE TË PUNËSUARVE
- KUJDESI PËR NXËNËSIT NGA FAMILJET E RREZIKUARA SOCIALE
- KUJDES PËR NXËNËSIT ME PROBLEME SHËNDETËSORE
- KUJDESI PËR MIRËQENIEN SOCIO-EMOCIONALE TË NXËNËSVE
- DHËNIA E NDIHMËS GJATË PËRZGJEDHJES PËR VAZHDIMIN E ARSIMIT

SHUMË MIRË

- Shkolla ka protokoll në të cilin janë përkufizuar të gjitha format e dhunës dhe mënyrat e veprimit.

Protokolli është i arritshëm për të gjithë (mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit). Të punësuarit e dinë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në procesin e mbrojtjes së fëmijës. Shkolla mban evidencë për format e shfaqura të dhunës. Në shkollë veprohet sipas protokollit për çdo formë të dhunës, i manifestuar nga të rriturit dhe nxënësve dhe njoftohen me kohë dhe bashkëpunohet me qendrat për punë sociale, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet shëndetësore. Fëmijët viktimë të dhunës, prindërit e tyre dhe/ose dëshmitarët e dhunës janë të njoftuara nga shkolla me të drejtat dhe procedurat për parashtrimin e ankesave, e në rast të ankesës, shkolla vepron me kohë dhe në mënyrë të paanshme. Shkolla ka procedura për punë konstruktive me të gjithë nxënësit të cilët janë pjesë e dhunës moshatare dhe me prindërit e tyre. Pas aktiviteteve të ndërmarra, dhuna e nivelit të parë dhe të dytë në shkollë ulet, dhe nuk ka dhunë të nivelit të tretë.

- Në godinën shkollore, në vende të dukshme, janë vendosur shenja për ndalimin e pirjes së duhanit, futjes dhe konsumit të alkoolit, shpërndarjes dhe konsumit të substancave narkotike. Në shkollën realizohen një numër i madh i aktiviteteve për mbrojtje nga ndikimet e dëmshme të pirjes së duhanit, alkoolit dhe mjeteve narkotike.

- Shkolla kujdeset për kualitetin e ushqimit që u është ofruar nxënësve në shkollë. Në shkollë zhvillohet sferatë për të ushqyerit e shëndoshë.
- Në shkollë tualetet janë të pastra dhe të dezinfektuara në çdo kohë të ditës dhe i përmbushin rregullat ligjore. Shkollat një herë në vit bën dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim. Në aspektin edukativ vepron që nxënësit të mirëmbajnë higjienën personale. Korridoret dhe shkallët pastrohen së paku tre herë në ditë, dysHEMEJA dhe mobiliat në klasa pastrohen së paku para fillimit të çdo ndërrimi, hapësira tjetër e shkollës së paku një herë gjatë ditës, ndërsa dritaret, dyert dhe inventari tjetër së paku dy herë në çdo gjysmëvjetor. Oborri i shkollës është i pastër dhe i rregulluar në aspektin hortikulturor. Në oborrin e shkollës, në secilën klasë dhe në korridoret ka shporta për mbeturina. Shkolla ka program për parandalim nga sëmundjet ngjitëse. Të gjithë të punësuarit dhe nxënësit rregullisht bëjnë kontrolle sistematike. Në shkollë ka persona që kanë certifikata për dhënien e ndihmës së parë.
- Në shkollën ka aparate zjarrfikëse që servisojnë rregullisht. Hidrantët janë funksionalë dhe ka dokument për matjen e kryer të instalimit të rrufepritësit. Në godinën shkollore ekziston plan për evakuim që është vendosur në vend të dukshëm dhe të arritshëm dhe një herë në vit bëhet simulimi për braktisjen e shpejtë të ndërtesës në rast të fatkeqësisë elementare dhe rrezikut tjetër.
- Shkolla i identifikon dhe siguron mjete materiale për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale. Shkolla bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me prindërit/kujdestarët, bashkësinë lokale dhe me institucione të tjera relevante (qendra për punë sociale, organizata humanitare dhe joqeveritare dhe bashkësi afariste) për ndihmë dhe mbështetje të nxënësve nga familjet e rrezikuara sociale.
- Shkolla siguron realizimin e mësimin për nxënësit që për shkak të arsyeve shëndetësore një kohë të gjatë mungojnë nga mësimi i rregullt. Realizimi i mësimin zbatohet në bashkëpunim me prindërit/kujdestarët, bashkësinë lokale dhe/ose institucione të tjera relevante (institucione shëndetësore, qendra për punë sociale).
- Shërbimi profesional në shkollë ka mekanizma për të dalluar vështirësitë socio-emocionale të nxënësit. Bashkëpunëtorët profesional janë të trajnuar që t'u ndihmojnë nxënësve me vështirësi emocionale dhe prindërve/kujdestarëve të tyre ose t'i udhëzojnë te institucionet relevante (qendra këshillimore, institucione shëndetësore, qendra për punë sociale, shoqata qytetare, etj). Në shkollë zbatohen aktivitete për nxënie socio-emocionale.
- Shkolla me kohë u siguron nxënësve informacione të qarta dhe të sakta për mundësitë për vazhdimin e arsimit. Për këtë qëllim organizon aktivitete personale dhe përdorë materiale promovuese nga institucionet arsimore

për orientimin profesional të nxënësve. Shkolla i informon rregullisht prindërit dhe nxënësit për ndihmën që mund ta marrin përmes kumtesave me shkrim dhe me gojë. Shkolla u jep ndihmë nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve të tyre në zgjedhjen e shkollës së mesme.

dëmshme të pirjes së duhanit, alkoolit dhe mjeteve narkotike.

- Shkolla kujdeset për kualitetin e ushqimit që u është ofruar nxënësve në shkollë. Në shkollë nuk zhvillohet sferatë për të ushqyerit e shëndoshë.
- Tualetet janë të pastra në çdo kohë të ditës. Shkollat një herë në vit nuk bën dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim. Korridoret, shkallët, dyshemeja dhe hapësira tjetër e shkollës pastrohen së paku një herë gjatë ditës, mobiliat një herë në javë, ndërsa dritaret, dyert dhe inventari tjetër së paku një herë në çdo gjysmëvjetor. Oborri i shkollës është i pastër, por nuk është i rregulluar sa duhet në aspektin hortikulturor. Në shkollë ka shporta të pamjaftueshme për mbeturina. Në rast të shfaqjes së sëmundjes ngjitëse, shkolla miraton procedurë të dakorduar për mbrojtje nga përhapja e saj. Të gjithë të punësuarit dhe nxënësit rregullisht bëjnë kontrolle sistematike. Në shkollë nuk ka persona të trajnuar për të dhënë ndihmën e parë.
- Në shkollën ka aparate zjarrfikëse që nuk servisojnë rregullisht. Hidrantët janë funksionalë. Nuk ka dokument për matjen e kryer të instalimit të rrufepritësit. Në godinën shkollore ekziston plan për evakuim që është vendosur në vend të dukshëm, por vitin e fundit nuk është bërë simulimi për braktisjen e shpejtë të ndërtesës në rast të fatkeqësive elementare dhe rrezikut tjetër.

PJESËRISHT KËNAQ

- Shkolla nuk ka protokoll në të cilin janë të përkufizuara të gjitha format e dhunës dhe mënyrat e veprimit. Të punësuarit e dinë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në procesin e mbrojtjes së fëmijës. Shkolla mban evidencë për format e shfaqur të dhunës. Fëmijët viktimë të dhunës, prindërit e tyre dhe/ose dëshmitarët e dhunës nuk janë të njoftuar nga shkolla me të drejtat dhe procedurat për parashtrimin e ankesave, e në rast të ankesës, shkolla vepron. Shkolla nuk ka procedura për funksionim konstruktiv me të gjithë nxënësit që janë pjesë e dhunës moshatare dhe prindërit e tyre. Aktivitetet e ndërmarra nuk kontribuojnë në uljen e dhunës në shkollë. Në ndërtesën e shkollës ekziston plan evakuimi.
- Në godinën shkollore, nuk janë vendosur shenja për ndalimin e pirjes së duhanit, futjes dhe konsumit të alkoolit, shpërndarjes dhe konsumit të substancave narkotike. Në shkollën realizohen një numër i vogël i aktiviteteve për mbrojtje nga ndikimet e

- Shkolla i identifikon, por nuk siguron mjete materiale për nxënësit nga familjet e rrezikuara sociale. Shkolla bashkëpunon jorregullisht me faktorët e ndryshëm nga bashkësia për ndihmë dhe mbështetje të nxënësve nga familjet e rrezikuara sociale.
- Shkolla kohë pas kohë siguron realizimin e mësimi për nxënësit që për shkak të arsyeve shëndetësore një kohë të gjatë mungojnë nga mësimi i rregullt. Me këtë rast nuk ka bashkëpunim me bashkësinë lokale dhe/ose institucione të tjera relevante (institucione shëndetësore, qendra për punë sociale).
- Shërbimi profesional në shkollë reagon në raste të vështirësive socio-emocionale të nxënësit. Bashkëpunëtorët profesional nuk janë të trajnuar mjaftueshëm që t'u ndihmojnë nxënësve me vështirësi emocionale dhe prindërve të tyre ose t'i udhëzojnë te institucionet relevante (qendra këshillimore, qendra për punë sociale, polici, shoqata qytetare, etj). Në shkollë nuk zbatohen aktivitete për nxënie socio-emocionale.
- Informacionet për mundësitë për vazhdimin e arsimit që shkolla ua siguron nxënësve nuk janë gjithmonë me kohë dhe të qarta. Shkolla organizon aktivitete për orientimin profesional të nxënësve vetëm me kërkesë të subjekteve të jashtme. Përgatitja që e organizon shkolla për nxënësit për përzgjedhjen e arsimit të mëtejshëm është kufizuar në informacione të përgjithshme që jepen me kërkesë të


prindërve dhe nxënësve. Shkolla, vetëm me kërkesë të nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve të tyre, u ndihmon në zgjedhjen e shkollës së mesme.


DOKUMENTE

- Udhëzues për procedurën për denoncim dhe mbrojtje të nxënësit viktimë të çfarëdo forme të dhunës, keqpërdorimit dhe mospërfilljes
- Rregullore për regjistrimin e fëmijëve të cilët nuk janë të përfshirë në mësimin, ndërsa janë me kufi të kaluar të moshës
- Programi për orientim profesional për nxënësit e klasës së tetë dhe të nëntë
- Udhëzues për mirëmbajtjen e objekteve shkollore
- Rregullore për standardet për të ushqyerit dhe racionet në shkollë fillore

BURIMET E TË DHËNAVE

Kodi i sjelljes; rendi shtëpiak i shkollës; mbikëqyrja e kushteve në shkollë; protokoll për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna; anketa/intervista me mësime dhënësit, prindërit dhe me nxënësit; evidenca pedagogjike për masa të shqiptuara pedagogjike; procesverbalet nga këshillimet; raporti për punën e shkollës (gjysmëvjetor, vjetor); procesverbale nga këshilli i prindërve dhe mbledhjet prindërore; anketa dhe intervista me drejtorin, prindërit, mësime dhënësit dhe me bashkëpunëtorët profesionalë; evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni; tribunat e organizuara, debate, ligjërata me nxënësit, prindërit dhe me përfaqësuesit e bashkësisë lokale për tema të lidhura me: shëndetin mental, shkathtësi socio-emocionale, jetesë e shëndetshme, etj.; procesverbale nga aktivitetet e zbatuara për orientim profesional.





SFERA 4: MENAXHIM, UDHËHEQJE DHE HARTIM TË POLITIKAVE

SFERA 4: MENAXHIMI, UDHËHEQJA DHE HARTIMI I POLITIKAVE

NUMRI	INDIKATORI	TEMA
4.1	Menaxhimi dhe udhëheqja e shkollës	• Menaxhimi i shkollës • Udhëheqja e shkollës • Menaxhimi dhe udhëheqja e resurseve • Udhëheqja e kuadrit • Ndjekja dhe përmirësimi i procesit mësimor
4.2	Qëllimet dhe hartimi i politikës shkollore	• Procedurat për hartimin e politikave shkollore • Rezultatet e planifikimit zhvillimor • Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit të shkollës

4.1

MENAXHIM DHE UDHËHEQJE E SHKOLLËS

TEMA:

- MENAXHIM I SHKOLLËS
- UDHËHEQJA E SHKOLLËS
- MENAXHIM DHE UDHËHEQJE E RESURSEVE
- UDHËHEQJA E KUADRIT
- NDJEKJE DHE AVANCIM I PROCESIT MËSIMOR

SHUMË MIRË

- Këshilli i shkollës është konstituuar në përputhje me rregullativën ligjore. Puna e këshillit shkollor është përkufizuar qartë me rregulloren për punë të këshillit të shkollës dhe është transparente. Këshilli i shkollës ka vendosur raport partneriteti me organin udhëheqës të shkollës dhe strukturat tjera shkollore. Të gjithë anëtarët e këshillit të shkollës njoftohen me kompetencat. Anëtarët e këshillit të shkollës i shqyrtojnë në detaje dhe miratojnë dokumentet programore të shkollës. Këshilli i shkollës në periudhë tremujore ndjekë shpenzimin e buxhetit, me qëllim që të ketë qasje në mjetet e shpenzuara financiare.

- Organi udhëheqës ka vizion të qartë të shkollës me të cilin janë njoftuar të gjithë faktorët e përfshirë në jetën e shkollës. Ai punon në mënyrë ekipore gjatë procesit të ndërtimit të politikave, planifikimit dhe sigurimit të kualitetit. Risetë në arsim i implementon në nivel të shkollës. I ndjekë në vazhdimësi planet e veprimit për realizimin e programit zhvillimor. Vendosë partneritetet me mjedisin e drejtpërdrejt lokal, mjedis afarist dhe organizata qytetare. Drejtori e përfshin shkollën në rrjete shkollore rajonale dhe ndërkombëtare.

- Drejtori ka plan dhe orar të qartë për përdorimin maksimal të kapaciteteve në dispozicion për realizimin e mësimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore, me çka i kënaq nevojat e nxënësve. Shkolla planifikon dhe siguron me kohë material të shpenzuar në sasinë e nevojshme për realizimin e aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore. Biblioteka shkollore/mediateka ka në dispozicion më shumë se pesë libra për nxënësit, duke përfshirë edhe botimet e lekturve, të përfaqësuar në mënyrë proporcionale sipas gjuhëve mësimore që mësohen në shkollën. Biblioteka ka sallë leximi, është e mirëpërcaktuar, ka në dispozicion kompjuter, ka qasje në internet dhe evidencë të bibliotekës zhvillohet në përputhje me rregullativën ligjore. Në bibliotekat udhëhiqet evidencë elektronike për librat e dhënë dhe të kthyer.

Biblioteka është e hapur për përdorim nga nxënësit dhe mësime dhënësit gjatë ditës së shkollës dhe punon në përputhje me renditjen për orarin e punës së bibliotekistit.

- Shkolla ka kuadër përkatës mësime për realizimin e të gjitha planeve dhe programeve mësime, si dhe bashkëpunëtorëve profesionale. Në shkollë funksionojnë mekanizma për zëvendësimin e mësime dhënësit dhe plotësim të mësimit në raste të mungesës afatshkurtër dhe afatgjatë. Staf mësime dhënësit është i shpërndarë në atë mënyrë që siguron përdorimin adekuat dhe efikas të resurseve mësime, me ç'rast numrin më i madh i klasave në shkollë kanë numër optimal të nxënësve në përputhje me normativat dhe standardet. Programi për zhvillim profesional të mësime dhënësit dhe bashkëpunëtorëve profesional është përpiluar në bazë të planeve të tyre personale zhvillime. Ekziston praktikë që çdo vit të bëhet diseminacion i trajnimeve bazike. Shkolla organizon dhe i përfshin kuadrin mësime dhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionale në trajnime interne dhe eksterne, në përputhje me nevojat e kuadrit, reformat arsimore dhe rrjedhat bashkëkohore arsimore. Drejtori e respekton rregullativën ligjore për zhvillim profesional dhe në karrierë të kuadrit. Shkolla ka mekanizma të brendshme për dhënie e mirënjohjeve për kuadrin që përfshinë inovacione efektive në punë. Kuadri mësime dhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional kanë dosje të përditësuara profesionale.

Shkolla ka procedurë të përcaktuar për organizimin dhe realizimin e stazhit të praktikantit.

- Drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionale, pas orarit të përpiluar paraprakisht, e ndjekin në mënyrë të vazhdueshme punën e mësime dhënësit. Secili mësime dhënësit ndiqet në së paku dy orë mësime gjatë një gjysmëvjetori për çka jepet informacion kthyes. Për ndjekjen e orës mësime drejtori dhe bashkëpunëtorët profesionale përdorin çek-lista/protokolle të përgatitura si përgatitje për ndjekje të suksesshme të orës mësime.

PJESËRISHT KËNAQ

- Këshilli i shkollës është konstituuar në përputhje me rregullativën ligjore dhe statusin e shkollës, por nuk ka miratuar rregulloren për punë. Ka raste të prolongimit/mosmbajtjes së seancave të keshillit të shkollës për shkak të mungesës së kuorumit për punë. Këshilli i shkollës bashkëpunon me organin drejtues të shkollës dhe strukturat tjera arsimore vetëm në nivel formal. Nuk ka transparencë gjatë publikimit të të gjitha vendimeve që i miraton keshilli shkollor. Anëtarët e keshillit të shkollës nuk njoftohen me kompetencat. Këshilli i shkollës në nivel vjetor ndjekë shpenzimin e buxhetit, me qëllim që të ketë qasje në mjetet e shpenzuara financiare.


- Organi udhëheqës ka vizion të qartë për zhvillimin e shkollës, por nuk e ndan atë me të gjithë faktorët e përfshirë në jetën e shkollës. Ai punën e vet nuk e bazon gjithmonë në punën ekipore. Ndryshimet në arsim i implementon me vështirësi në shkollë. Nuk e ndjekë mjaftueshëm implementimin e prioriteteve të identifikuara në programin zhvillimor. Bashkëpunimi me mjedisin lokal, afarist dhe organizatat qytetare realizohet vetëm me kërkesën e tyre.
- Në shkollë përpilohet plan dhe orar për përdorimin e kapaciteteve në dispozicion për realizimin e mësimi dhe aktiviteteve jashtëshkollore. Shkolla siguron material shpenzues, me kërkesë të mësimdhënësve për realizimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëshkollore. Biblioteka shkollë/mediateka ka në dispozicion më shumë se dy libra për nxënësit, duke përfshirë edhe botimet e lekturve, por nuk ka në të gjitha gjuhët mësimore që mësohen në shkollë. Biblioteka nuk ka sallë leximi dhe evidenca e bibliotekës udhëhiqet në përputhje me Ligjin për bibliotekat. Biblioteka është e hapur për përdorim nga nxënësit dhe mësimdhënësit sipas orarit të hartuar.
- Shkolla ka kuadër përkatës mësimor për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, si dhe bashkëpunëtorëve profesionalë. Në shkollë procedura për zëvendësimin e mësimdhënësve dhe plotësim të mësimi në raste të mungesës afatshkurtër dhe afatgjatë zbatohet me vështirësi.

Programi për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional nuk përpilohet në bazë të planeve të tyre personale zhvillimore. Shkolla nuk praktikon diseminacion të rregullt të trajnimeve bazike. Shkolla përfshin kuadrin mësimdhënës dhe bashkëpunëtorët profesionalë në trajnime eksterne, pa respektuar nevojat e kuadrit. Drejtori e respekton rregullativën ligjore për zhvillim profesional dhe në karrierë të kuadrit, por nuk mekanizma të brendshme për dhënie të mirënjohjeve për kuadrin që përfshinë inovacione efektive në punë. Kuadri mësimdhënës dhe bashkëpunëtorët profesional nuk kanë dosje tërësisht të përditësuara profesionale. Shkolla ka procedurë të përcaktuar për organizimin dhe realizimin e stazhit të praktikantit.

- Ndjekja e orëve dhe dhënia e informacionit kthyes nuk është e planifikuar paraprakisht dhe e vazhdueshme. Drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollë, vetëm me kërkesë të mësimdhënësve u ndihmojnë në realizimin e mësimi përmes ndjekjes së orëve mësimore. Për ndjekjen e orës mësimore drejtori dhe bashkëpunëtorët profesionalë nuk përdorin çek-lista/protokolle si përgatitje për ndjekjen e suksesshme të orës mësimore.

BURIMET E TË DHËNAVE

Programi për punë i këshillit të shkollës;
rregullore për punën e këshillit të shkollës;
statuti i shkollës; procesverbalet, vendimet
dhe raportet nga puna e këshillit të shkollës
(vjetor, gjysmëvjetor, të veçantë); program
zhvillimor i shkollës; program për punën e
drejtorit; programe për zhvillim profesional;
dëshmi për pjesëmarrje dhe diseminicion të
trajnimeve (listave, agjendave, listave të
evaluimit); intervista me mësimdhënës,
prindër dhe nxënës dhe këshillin e shkollës;
orar dhe procedura për përdorimin e
hapësirës dhe materialeve në shkollë;
pyetësor për personin përgjegjës nga komuna;
dëshmi për përfshirje në rrjete rajonale dhe
ndërkombëtare arsimore (aktivitete, shkresa,
aplikime), aktivitete dhe program për punën e
bibliotekës shkollore/mediatekë.



4.2

QËLLIME DHE HARTIM I POLITIKËS SHKOLLORE

TEMA:

- PROCEDURA PËR HARTIMIN E POLITIKËS SHKOLLORE
- REZULTATET NGA PLANIFIKIMI ZHVILLIMOR
- PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT SHKOLLOR

SHUMË MIRË

- Shkolla ka procedura të përcaktuara për miratimin e politikave shkollore, në të cilat janë të përfshirë të punësuarit, nxënësit, strukturat shkollore dhe faktorët tjerë. Shkolla vazhdimisht i përmirëson politikat për avancimin e kualitetit së funksionimit në shkollë.
- Qëllimet në programin zhvillimor janë konkrete, të realizueshme dhe reflektojnë sfidat e identifikuara nga vetëvlerësimi dhe evaluimi integral i shkollës. Gjatë vendosjes së tyre janë përfshirë mësimdhënësit-mentorë, mësimdhënësit, prindërit, nxënësit, këshilli shkollor dhe përfaqësuesit e bashkësisë lokale. Shkolla i informon mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit për rezultatet që duhet të arrihen dhe dinamikën për realizim. Shkolla ka plane veprimi për arritjen e rezultateve nga qëllimet e vendosura. Shkolla ka plan

për ndjekjen dhe evaluimin e programit zhvillimor, ndërsa qëllimet e planifikuara realizohen në mënyrë të përpiktë.

- Drejtori i informon organet dhe trupat e shkollës për buxhetin shkollor dhe shpenzimin dhe përpilon plan financiar për shpërndarjen e mjeteve financiare. Prioritetet buxhetore janë të lidhura ngushtë me prioritetet e qëllimeve arsimore të shkollës. Buxheti përdoret me dedikim dhe për qëllime që janë të fokusuara në përmirësimin e kualitetit së mësimi dhe nxënies, përmirësimin e arritjeve të nxënësve, si dhe zhvillimin e shkollës në tërësi. Planin financiar është aprovuar nga Këshilli i shkollës dhe Këshilli i komunës.

PJESËRISHT KËNAQ

- Shkolla ka procedura të dakorduara për miratimin e politikave shkollore, të cilat i përfshijnë strukturat udhëheqëse. Shkolla rrallë i përmirëson politikat për avancimin e kualitetit së funksionimit në shkollë.
- Qëllimet në programin zhvillimor nuk i reflektojnë mjaftueshëm sfidat e identifikuara nga vetevaluimi dhe evaluimi integral i shkollës. Gjatë vendosjes së tyre janë përfshirë drejtori dhe një pjesë e mësimdhënësve. Shkolla i informon mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit për rezultatet që duhet të

arrihen. Shkolla ka plane veprimi për arritjen e rezultateve nga qëllimet e vendosura. Shkolla ka plan për ndjekjen dhe evaluimin e programit zhvillimor, por nuk e respekton dinamikën e ndjekjes dhe evaluimit.

- Drejtori i informon organet dhe trupat e shkollës për buxhetin shkollor dhe shpenzimin. Prioritetet buxhetore nuk janë gjithmonë të lidhura me prioritetet e qëllimeve arsimore të shkollës. Buxheti përdoret për qëllime afatshkurtra ose prioritete që nuk janë të ndërlidhura me përmirësimin e kualitetit së mësimi dhe nxënies, përmirësimin e arritjeve të nxënësve, si dhe zhvillimin e shkollës në tërësi. Plani financiar është aprovuar nga Këshilli i shkollës dhe Këshilli i komunës.

BURIMET E TË DHËNAVE

Programi zhvillimor i shkollës; programi vjetor i punës së shkollës; raporti nga vetevaluimi; plani për ndjekjen dhe evaluimin e realizimit të planeve të veprimit; anketa/intervista me drejtorin, bashkëpunëtorët profesionalë, mësimdhënësit, prindërit, nxënësit; procesverbale nga këshilli i shkollës, këshilli i prindërve, këshilli i mësimdhënësve; akte interne; programi për punë dhe raporte për punën e këshillit të shkollës; plani për zhvillim profesional; buxhet dhe plan financiar të shkollës.

